

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon Mbretëria e Bashkuar: Vendimi të mos përdoret për të ndezur te nsione
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/aktualitet/denimi-i-ish-krereve-te-uk-se-reagon-mb-reteria-e-b-i1185202
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 15:28:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 15:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	38c4cfbe6d092652c66feb7257ac13b92c1b636c383d60192d9be0857b1ef64b
TEKSTI	57d2c80cbe2b84c18d05cec2401fcd45858582712124d779c12b18be59ad3403
PAMJA	16a29a60f122435af985da85e76c3c03d014cf78923e721fe7aea077ef1fc033

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8451e819de510de8490a47b1ff98615502098e528e09cbbd0ba44b63e8d8aae0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c11531ba0c325ce57cb42979570286028b15ce78f5f30478d991f53d7430dd86
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8451e819de510de8490a47b1ff98615502098e528e09cbbd0ba44b63e8d8aae0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon Mbretëria e Bashkuar: Vendimi të mos përdoret për të ndezur tensione



Nga A2 CNN
16 Shtator 2026, 17:21 | Aktualitet



Mbretëria e Bashkuar ka reaguar pas vendimit të gjykatës së Hagës për 4 ish-krerët e UÇK-së, duke u bërë thirrje të gjitha palëve që vendimi të mos përdoret për të nxitur tensione.

Ministri britanik për Evropën, Lord Wood i Anfieldit, tha se Mbretëria e Bashkuar respekton pavarësinë e Gjykatës dhe procesin e saj gjyqësor dhe mbetet e përkushtuar ndaj drejtësisë, llogaridhënies dhe pajtimit në të gjithë rajonin.

"Mbretëria e Bashkuar mbetet një mik dhe partner i ngushtë i Kosovës, duke mbështetur fuqimisht sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të saj, si dhe paqen në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Jemi krenarë për rolin që luajtëm përkrah aleatëve të NATO-s në ndihmën për parandalimin e një katastrofe humanitare në vitin 1999 dhe në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Vendimi i sotëm nga Dhomat e Specializuara të Kosovës është një moment i rëndësishëm, por nuk është një gjykim mbi shtetësinë, sovranitetin apo të drejtën e Kosovës për të përcaktuar të ardhmen e saj. Mendimet e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar janë me viktimat dhe familjet e tyre", u shpreh ai.

Sipas tij gjetjet e gjykatës kanë të bëjnë me përgjegjësinë e individëve dhe nuk duhet të përdoren për të nxitur tensione mes komuniteteve apo në të gjithë rajonin.

"Gjetjet e Gjykatës kanë të bëjnë me individët dhe nuk duhet të përdoren për të ndezur tensione midis komuniteteve ose në të gjithë rajonin. Në këtë moment të rëndësishëm, udhëheqësit politikë dhe figurat publike kanë përgjegjësinë të promovojnë qetësinë, të sigurojnë që çdo reagim të mbetet paqësor dhe të vënë sigurinë e njerëzve në radhë të parë. Mbretëria e Bashkuar do të vazhdojë të punojë me partnerë në të gjithë rajonin dhe më gjerë për të mbështetur paqen, drejtësinë dhe një të ardhme të sigurt dhe të begatë për të gjitha komunitetet." (A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

TE FUNDIT

Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çfarë konstatoi trupi gjyqësor?

Vendimi në Hagë për ish-krerët e UÇK-së, DASH për A2 CNN: Mbështesim drejtësinë për të gjitha viktimat

Grenell: Kurti duhet ta shpërbëjë Gjykatës Speciale

Suedia dëbon zyrtarin iranian, përplasje diplomatike mes Stokholmit dhe Teheranit

MË TË VIZITUARAT

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon SHBA: Respektojmë aktgjykimin

Dënimi i krerëve të UÇK, PD gati rezolutën për të dënuar gjenocidin serb në K...

Trishtim dhe zhgënjim, institucionet dhe politika në Shqipëri kundër vendimev...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri



Milorad Dodik kundër vendimi për Hashim Thaçinin: Duhej dënuar për krime kundër njerëzimit



Pas tensioneve para godinës së EULEX, qytetarët protestojnë para qeverisë, hidhen gurë drejt godinës



Nga lufta në Hagë! Çlirimtari, politikani dhe i pandehuri, 3 jetët e Hashim Thaçit



Çfarë u provua dhe çfarë jo? Surroi: 9 pika për të kuptuar vendimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së



Reagimet në Prizren pas vendimit: Për çfarë luftuam, Evropa vazhdon keqtrajtimin e shqiptarëve




"Do presim Apelin", mbështetësit e Thaçit flasin me lot në sy për vendimin e Hagës

Latest Videos



"Ata që kanë bërë genocid asnjë nuk është dënuar me kaq vite sa është dënuar Hashim Thaçi"



Koci: Është rast unik që 4 të akuzuar mbahen në burg për 6 vite





"Është një vendim skandaloz, ishte cinizëm të thoje "Në emër të popullit të Kosovës"



"UÇK, UÇK" Thirrjet e qytetarëve të revoltuar poshtë zyrës së Kurtit. Edhe gurë drejt Kryeministrisë

Shqipëria

Aktualitet

Kronikë

Politikë

Ekonomi

Sociale

Kulturë

Moti

Kosova

Kulturë

Sociale

Ekonomi

Politikë

Kronikë

Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani

Bota

Argëtim

Showbiz

Lifestyle

Kapur në kamera

Teknologji

Sport

Live Euro 2024

Futboll

Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta

A2 CNN në Izrael

31 Minuta

A2 CNN në Ukrainë

Lumi i kokainës

Ditari ndërkombëtar

Zbulio

Imagjinatë

Dëshmi

A2 CNN LOGO

Live TV

Rreth nesh

Kushtet e Privatësisë

Karriera

Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk

All Rights Reserved.

Mundësiuar nga

Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.